




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr 628/1prot.


Shkodër, më 7.10.2022

Nr. 5027/1 Prot
Dt. 11.10.22



LËNDA: Mbi vendimin Nr.57 datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS



Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Ministrisë të Brendshme Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, neni 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 shkronja e/1, neni 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25,pika 1/c, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, pika 49, shtojcës nr.47, Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit nr.1 datë.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik”, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, dokumentacionin shoqëruar të mbledhjes së Këshillit Bashkia Vau-Dejës datë 23.09.2022 dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkia Vau-Dejës Nr.5022prot datë 28.09.2022 u shqyrtua VKB Nr.57 datë 23.09.2022 Vau-Dejës: “Për dhënie në përdorim me afat 10-vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 413.728 ha të ekonomisë pyjore Gomsiqe ngastrat (89, 90, 91, 95, 97, 99, 100a, 100b, 101, 102, 103a, 103b, 103c, 104b, 105b) dhe ekonomie pyjore Gjader Mnelë ngastrat (6a, 6b, 7, 8, 9, 10a, 10b, 11, 39, 40, 44, 45, 53) “Për aerogjeneratorë(stacione,objekte përkatëse etj”.

Pasi shqyrtimit të vkb dhe materialit bashkëlidhur, për trajtim të mëtejshëm, Prefekti kërkon të bëni plotësimin dhe saktësimin e ngastrave sipas VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, pasi të ekonomie pyjore Gomsiqe, ngastrat (89, 90, 91, 95, 97, 99, 100/a, 100/b, 101, 102) dhe ekonomia pyjore Gjader Mnelë, ngastrat (39, 40, 44, 45, 53) nuk janë pjesë listës të miratuar në VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 57 datë 23.09, 2022

“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 413.728 ha “Për Aerogjeneratorë (stacionet,objektet përkatëse etj).në ekonomitë pyjore Gomsiqe dhe Gjader Mnele.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/ kullor publik me shumice të ciluar votash:

V E N D O S I

- 1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 413.728 ha “për aerogjeneratorë(stacionet,objektet përkatëse etj) në ngastrat nr.89;90;91;95;97;99;100a;100b;101;102;103a;103b;103c;104b;105b të ekonominë pyjore Gomsiqe dhe ngastrat nr.6a;6b;7;8;9;10a;10b;11;39;40;44;45;53; të ekonomisë Pyjore Gjader Mnelë.
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjet me te drejte rinovimi.
2. Tarifat e dhenies me qira duhet të vendosen në kontratë pas konkurimit publik sipas VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, dhe Turizmit dhe mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R
MARK BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN ÇELEPIJA

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022